



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

TV MEN
Shukri Sylejmani
Drejtör
Gjilan

Ankesa Nr. 2011/ 25- KPM vs TV MEN
Ref:1210/862/KPM/a.z

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2011/25-Komisioni i Pavarur për Media (KPM) kundër TV MEN (Pala Përgjegjëse)

Faktet

1. KPM më datën 18 shkurt 2009, ka vendosur që subjektit transmetues TV Men-Pala Përgjegjëse t'i lëshoj licencën për të transmetuar programe brenda zonës së licencimit. Pala Përgjegjëse me marrjen e licencës është obliguar të respektoj Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës si dhe të gjitha aktet nënligjore të KPM-së, përfshi edhe Rregulloren për Subjektet Transmetuese për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbytjet e Dëmshme Programore (CIMC-2009/01).
2. KPM me 7 maj 2009, ka nxjerrë Rregulloren për Subjektet Transmetuese për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbytjet e Dëmshme Programore (CIMC-2009/01). Me këtë rregullore është përcaktuar mënyra e kategorizimit, sinjalizimit dhe zgjedhjes së kohës së transmetimit të atyre programeve të cilat mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, emocional dhe moral të fëmijëve dhe të miturve.
3. KPM vazhdimisht ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren për Subjektet Transmetuese për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbytjet e Dëmshme Programore (CIMC-2009/01). KPM me datën 18, 19 dhe 20 mars 2011, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka dështuar të veproj në pajtueshmëri me Rregulloren CIMC-2009/01.
4. KPM, bazuar në shkeljen e Rregullores CIMC-2009/01, nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 25 mars 2011, i ka dërguar Njoftim për Shkelje me të cilin është kërkuar nga Pala Përgjegjëse të veproj në pajtueshmëri me Rregulloren CIMC 2009/01, në të kundërtën KPM në bazë të Ligjit të KPM-së, do të ndërmerr masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.

5. KPM edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, sërish me datën 15, 16 dhe 17 prill 2011, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren CIMC-2009/01. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për Shkelje të datës 25 mars 2011, ka vazhduar të veproj në kundërshtim me Rregulloren CIMC-2009/01 pasi që nuk ka bërë paralajmërimin në mënyrë akustike, vizuale dhe tekstuale, për përmbajtjet e dëmshme programore për fëmijë para fillimit të programit si dhe nuk ka bërë kategorizimin e programeve në pajtim me Rregulloren CIMC-2009/01.
6. KPM bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Rregullores CIMC-2009/01, nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 9 gusht 2011 i ka dërguar Vërejtje për shkelje të nenit 3.3 të Rregullores CIMC-2009/01. KPM me anë të vërejtjes ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse të veproj në pajtueshmëri të plotë me Rregulloren CIMC-2009/01, në të kundërtën KPM në bazë të Ligjit të KPM-së, do të ndërmerr masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
7. KPM sërish prej datës 8 deri me datën 14 tetor 2011, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren CIMC-2009/01. Në bazë të monitorimit është konstatuar se Pala Përgjegjëse, ka vepruar në kundërshtim me nenin 7.4 pasi që nuk bërë paralajmërimin në mënyrë akustike, vizuale dhe tekstuale, për përmbajtjet e dëmshme programore për fëmijët para fillimit të programit. Pala Përgjegjëse gjithashtu është gjetur se ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 3.3 pasi që nuk i ka identifikuar me simbol përkatës vizual programet me përmbajtje të dëmshme gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre. Po ashtu në bazë të monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 6.2.3 dhe 6.2.4.
8. KPM sërish me datën 14 dhe 15 nëntor 2011, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse ku ka gjetur se Pala Përgjegjëse vazhdon të veproj në kundërshtim me Rregulloren CIMC-2009/01, konkretisht nenin 3.3, 6.2.3, 6.2.4 dhe 7.4.
9. KPM bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Rregullores CIMC-2009/01, nga ana e Palës Përgjegjëse sërish me datën 23 nëntor 2011, i ka dërguar Vërejtje për shkelje të nenit 3.3, 6.2.3, 6.2.4 dhe 7.4 të Rregullores CIMC-2009/01. KPM me anë të vërejtjes ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse të veproj në pajtueshmëri të plotë me Rregulloren CIMC-2009/01, në të kundërtën KPM në bazë të Ligjit të KPM-së, do të ndërmerr masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
10. KPM edhe pas Vërejtjes së dërguar ka vazhduar me monitorimin e Palës Përgjegjëse, ku me datën 19 dhe 20 shkurt 2012, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veproj në kundërshtim me Rregulloren CIMC-2009/01 neni 3.1, 3.3 dhe neni 7, edhe përkundër vërejtjes së KPM-së për të vepruar në pajtim me Rregulloren CIMC-2009/01.

Analiza Ligjore

11. Komisioni bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Nenet 3.1, 3.3, 6.2.3, 6.2.4 dhe 7.4 të Rregullores për Subjektet Transmetuese për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore CIMC-2009/01.

Neni 3.1 i Rregullores CIMC-2009/01 përcakton:

"Subjektet transmetuese nuk do të transmetojnë programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, përveçse në kohën dhe kushtet e përcaktuara me këtë rregullore"

Neni 3.3 i Rregullores CIMC-2009/01 përcakton:

“Subjektet transmetuese të cilat transmetojnë TV programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, obligohen që ato programe t'i paralajmërojnë me sinjal akustik apo tekstual dhe t'i identifikojnë me simbolin përkatës vizual gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre, sipas kategorizimit të programeve në këtë rregullore”

Neni 6.2.3 i Rregullores CIMC-2009/01 përcakton:

“Transmetimi i programeve, që i takojnë kategorisë së tretë, mund të bëhet prej orës 23:00 deri në orën 06:00”

Neni 6.2.4 i Rregullores CIMC-2009/01 përcakton:

“Transmetimi i programeve, që i takojnë kategorisë së katërt, mund të bëhet prej orës 24:00 deri në orën 05:00. Subjektet transmetuese mund të transmetojnë gjatë kësaj kohe programe me përmbajtje pornografike të cilat duhet të jenë të koduara”

Neni 7.4 i Rregullores CIMC-2009/01 përcakton:

“Para fillimit të programit në TV shfaqet shenja e programit, e cila është kombinim i vërejtjes tekstuale, verbale, akustike dhe vizuale në kohëzgjatje prej 10 sekondave dhe mbulon të paktën ¼ e pjesë së dukshme të ekranit”

12. KPM më datë 25 mars 2011 përmes Njoftimit për Shkelje ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse të veproj në pajtueshmëri me Rregulloren CIMC 2009/01, në të kundërtën KPM në bazë të Ligjit të KPM-së, do të ndërmer masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse
13. KPM, më datën 9 gusht 2011, i ka dërguar Vërejtje Palës Përgjegjëse për shkelje të nenit 3.3 të Rregullores CIMC-2009/01, me anë të cilës ka kërkuar nga Palës Përgjegjëse që të veproj në pajtueshmëri të plotë me këtë Rregullore. Pala Përgjegjëse edhe pas pranimi të Vërejtjes ka vazhduar të veproj në kundërshtim me Rregulloren CIMC-2009/01, pasi që nuk ka bërë paralajmërimin në mënyrë akustike, vizuale dhe tekstuale, për përmbajtjet e dëmshme programore për fëmijët para fillimit të programit.
14. Bazuar në raportet e monitorimi është gjetur se Pala Përgjegjëse edhe pas pranimi të Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjeve të dërguara nga KPM me të cilat i është bërë me dije se është në shkelje të Rregullores CIMC-2009/01, ka vazhduar të mos respektojë këtë Rregullore duke transmetuar programe jashtë kohës së lejuar me Rregullore si dhe duke mos i identifikuar programet me përmbajtje të dëmshme me sinjal akustik apo tekstual përmes simboleve të përkatëse vizuale, sipas kategorizimit të programeve me përmbajtje të dëmshme duke u bazuar në Rregulloren CIMC-2009/01.
15. Pala Përgjegjëse ka dështuar të veprojë në pajtim me nenin 3.1, 3.3, 6.2.3, 6.2.4 dhe 7.4 të Rregullores CIMC 2009/01 pasi që ka dështuara të paralajmëroj shfaqjen e programeve me përmbajtje të dëmshme sipas rregullave të përcaktuara me Rregulloren CIMC-2009/01.

16. Komisioni ka vazhduar me monitorimet e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me nenin 3.1, 3.3, 6.2.3, 6.2.4 dhe 7.4 dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk ka ndërmarr asnjë veprim në drejtim të respektimit të kësaj Rregullore, prandaj përmes kësaj Komisioni si rrethana rënduese për Palën Përgjegjëse merr shkeljet e vazhdueshëm të Rregullores CIMC-2009/01 dhe pas kërkesave të KPM-së për të vepruar në pajtueshmëri me Rregulloren CIMC-2009/01.
17. Komisioni është bazohet në Udhëzimin për Zbatimin e Sanksioneve ndaj të licencuarve i cili përveç tjerave thotë se KPM gjithmonë e ka parasysh natyrën proporcionale të sanksioneve. Sanksionet do të jenë proporcionale me natyrën dhe me seriozitetin e një shkeljeje dhe me shkallen ekonomike të të licencuarit, dhe nuk do të jenë më të rëndë se sa të nevojshme për të parandaluar shkelje tjera dhe për të inkurajuar veprime përmirësuese nga ana e të licencuarit, duke marrë parasysh të gjithë faktorët relevant lehtësues apo rëndues.
18. Komisioni duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të Nenit 3.1, 3.3, 6.2.3, 6.2.4 dhe 7.4 të Rregullores CIMC 2009/01.

VENDIM

19. Bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura, Komisioni gjen se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të Nenit 3.1, 3.3, 6.2.3, 6.2.4 dhe 7.4 të Rregullores CIMC 2009/01, pasi që ka transmetuar programe me përmbajtje të dëmshme programore jashtë kohës se lejuar me Rregulloren CIMC-2009/01, si dhe ka dështuar të bëjë paralajmërimin paraprak me sinjal akustik apo verbal gjatë transmetimit të programeve me përmbajtje të dëmshme programore.
20. Komisioni bazuar në nenin 30 pika 1 të Ligjit të KPM-së, vendos që Palës Përgjegjëse t'i shqiptohet masa sanksionuese **Vërejtje** për shkeljen e nenit 3.1, 3.3, 6.2.3, 6.2.4 dhe 7.4 të Rregullores CIMC 2009/01 .
21. Në rast se Pala Përgjegjëse edhe pas pranimi të këtij vendimi vazhdon të veprojë në kundërshtim me Rregulloren CIMC-2009/01 apo aktet tjera nënligjore të KPM-së, Komisioni do të iniciojë procedurë ligjore për ndërmarrjen e masave tjera sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse në pajtueshmëri me Nenin 30 të Ligjit të KPM-së.
22. Komisioni gjithashtu kërkon nga ana e Palës Përgjegjëse që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet të cilat bien ndesh me ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.

E drejta për Ankesë

23. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42 paragrafi 2 të ligjit të KPM-së.
24. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

25. Bordi për Ankesa mundet që pa dëgjim të hedh poshtë ankesat të cilat nuk janë të bazuara në njërën nga këto dy mundësi, apo të cilat, nën dispozitat e vendosura nga Bordi për Ankesa në pajtueshmëri me paragrafin 2. të nenit 42 të këtij ligji janë të papranueshme sepse janë të pa vlera keqdashëse apo të pabaza.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim



Shefki Ukaj

Kryetar

Komisioni i Pavarur për Media



04 tetor 2012

datë